

Me mijëra spanjollë manifestuan në Madrid për t'i kërkuar qeverisë që të përmbushë angazhimin e tij për të ngushtuar të drejtat e femrave për të abortuar.

Duke mbajtur flamuj që kishin sloganin “Çdo jetë vlen!”, manifestuesit parakaluan në kryeqytet, duke fërshëlyer me zemërim ndërkohë që kalonin para selisë së Partisë Popullore (PP, konservatorë), sipas gazetarëve në terren.

“Abortues, vrasës!”, bërtisnin disa. “Po jetës, jo abortit!”, therrisnin disa të tjerë.

Kryeministri spanjoll, Mariano Rajoy, kishte premtuar para se të zgjidhej në vitin 2011 se do të forcojë ligjin mbi abortin, por hoqi dorë nga ky projekt në shtator për shkak të mosmarrëveshjeve mbi këtë çështje brenda partisë së tij.

Kjo tërheqje ka ngjallur zemërimin e shumë përkrahësve të tij, që kërcënojnë se nuk do të votojnë më për atë në zgjedhjet e ardhshme të përgjithshme, të parashikuara në dhjetor 2015./trt/